TIRANA

TIRANA

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI» TIRANË, 1990

«TIRANA TË BËHET QYTETI MË I DASHUR I GJITHË POPULLIT... KRYEQYTETI DO TË ZHVILLOHET NGA ANA INDUSTRIALE, KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE... KËTU TË KETË SHKOLLA TË LARTA, KËTU TË JETË UNIVERSITETI I ARDHSHËM».

ENVER HOXHA

Monumenti i udhëheqësit të madh e të paharruar të Partisë e të popullit, shokut Enver Hoxha, në sheshin «Skënderbej» Tiranë.

Shoku Ramiz Alia, Sekretar i Parë i KQ të PPSH dhe Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH, në manifestimin tradicional të 1 Majit në Tiranë.

Tirana, kryeqyteti i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shtrihet në skajin juglindor të Fushës së Tiranës, në një sipërfaqe prej 31 km^2.

Në truallin që zë sot kryeqyteti, janë zbuluar gjurmë vendbanimi që i takojnë kohës antike. Emri i Tiranës përmendet në dokumente të shekullit VI të erës sonë, në aktet venedikase të 1418-ës, në veprën e humanistit të shquar shqiptar Marin Barleti etj.

Por themelimi i saj si qytet i takon fillimit të shekullit XVII. Gjatë shekujve të rëndë të pushtimit osman, si gjithë populli shqiptar edhe banorët e kësaj treve luftuan pa ndërprerje deri në shpalljen e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912.

Kongresi i Lushnjës, i mbledhur në janar të 1920-ës, e caktoi Tiranën kryeqytet të Shqipërisë. Në këtë kohë ajo numëronte 17 mijë banorë. Në qershor 1924 masat popullore të Tiranës morën pjesë gjallërisht në Revolucionin Demokratiko-Borgjez, që solli në fuqi qeverinë e Fan Nolit.

Gjatë viteve të regjimit antipopullor feudoborgjez, flamurin e lirisë e të demokracisë e morën forcat më përparimtare të drejtuara nga komunistët, që i dhanë një shtytje të re lëvizjes revolucionare në vend dhe përgatitën kushtet për themelimin e PKSH.

Ngjarja më e shënuar në historinë e popullit tonë ishte themelimi në Tiranë, më 8 Nëntor 1941, i Partisë Komuniste të Shqipërisë (sot PPSH) nga komunistët shqiptarë me shokun Enver Hoxha në krye. Po këtu u themelua edhe Organizata e Rinisë Komuniste të Shqipërisë. Në afërsi të Tiranës, më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës, që hodhi themelet e pushtetit popullor. Në përgjigje të thirrjes së Partisë edhe populli i Tiranës mbushi radhët e formacioneve partizane me bijtë dhe bijat më të mira të tij. Më 17 nëntor 1944, pas luftimesh të ashpra heroike, forcat e Ushtrisë NÇl, të mbështetura fuqimisht nga populli, çliruan Tiranën, kryeqytetin e atdheut tonë. Më 28 Nëntor 1944 banorët e Tiranës pritën ardhjen e Qeverisë Demokratike Popullore të kryesuar nga shoku Enver Hoxha.

Gjatë viteve të pushtetit popullor janë bërë shndërrime të thella në të gjitha fushat. Kryeqyteti sot ka mbi 230 mijë banorë, 6 herë më shumë se në 1938-ën. Në Tiranë është ngritur një industri moderne, e cila në 3 ditë realizon prodhimin e gjithë vitit 1938. Është e zhvilluar kryesisht industria mekanike, ajo e lehtë e ushqimore, ajo

e materialeve të ndërtimit etj. Tirana është një pellg i pasur qymyrguror. Në periferinë e saj janë ngritur miniera shfrytëzimi si në Valias, Mëzez, Mushqeta dhe Priskë.

Një zhvillim të madh ka marrë edhe bujqësia e blegtoria. Disa ndërmarrje e kooperativa bujqësore përreth saj japin prodhime me rendimente të larta. Punime të mëdha janë bërë dhe bëhen për ndërtimin e veprave ujitëse bujqësore dhe të komplekseve blegtorale.

Në Tiranë ka një rrjet të gjerë shkollash tetëvjeçare e të mesme. Ka gjithashtu universitetin «Enver Hoxha» dhe shkolla të tjera të larta si Institutin e Lartë të Arteve, Institutin e Lartë Bujqësor, institutin e kulturës fizike «Vojo Kushi» etj.

Tirana është qendër kryesore e institucioneve shkencore e artistike të vendit. Këtu ndodhen Akademia e Shkencave e RPSSH, dhjetëra institute studimore e kërkimore-shkencore, Pallati i Madh i Kulturës, Biblioteka Kombëtare, Teatri i Operas dhe i Baletit, Radiotelevizioni shqiptar, kinostudioja «Shqipëria e re», Teatri Kombëtar, ai i Estradës, Teatri i Kukullave, Pallati i Pionierëve të Enverit, Agjencia Telegrafike Shqiptare, disa shtëpi botuese etj. Në qendër të kryeqytetit ngrihen madhështorë muzeu «Enver Hoxha», Muzeu Historik Kombëtar, Pallati i Kongreseve etj. Përveç këtyre janë edhe Muzeu Arkeologjik, Galeria e Arteve Figurative, Ekspozita e Kulturës Popullore, ekspozita «Shqipëria sot» etj.

Tirana është sot nyjë kryesore e transportit automobilistik e hekurudhor dhe lidhet me të gjitha qendrat e rretheve të vendit. Nëpërmjet Aeroportit të Rinasit ajo lidhet me shumë vende të Evropës e të botës.

Me ndërtimet e shumta që janë bërë, Tirana e ka ndryshuar dhe po e ndryshon gjithnjë e më shumë pamjen e saj urbanistike. Janë ngritur pallate e ndërtesa shumëkatëshe dhe shëtitore e rrugë të gjera. Qytetin e zbukurojnë disa parqe të gjelbëruara, midis të cilave shquhet Parku i Madh, i ngritur në kodrat e liqenit artificial. Në periferinë e Tiranës ka edhe disa qendra turistike.

Klima e qytetit është mesdhetare. Dimri i butë, rrallë bie dëborë. Ditët në verë janë të nxehta, netët të freskëta.

Tirana, kryeqyteti i RPSSH, është shpallur Qytet-Hero. Ashtu si mbarë vendi ynë, edhe Tirana, në sajë të punës së masave popullore, të udhëhequra nga Partia e Punës e Shqipërisë me shokun Ramiz Alia në krye, zhvillohet e lulëzohet pandërprerë, çdo ditë e më shumë.

Mozaikë të zbuluar te vendi i quajtur Kroi i Shëngjinit (shek. VI i erës së re), që dëshmojnë për vendbanimin e hershëm të Tiranës.

Kalaja e Petrelës, 12 km në juglindje të Tiranës, ndërtuar në brigjet e Erzenit në shek. IV p.e.r. Në luftërat e Skënderbeut kundër hordhive osmane shërbeu si parafortesë e Krujës.

Ura e Brrarit, pranë saj ndodhen gjurmët e një kështjelle të lashtë të quajtur Tirkan.

Kalaja dhe sahati i Prezës, në veriperëndim të Tiranës, ndërtim i shek. XV.

Monumenti i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në qendër të Tiranës.



Xhamia e vjetër «Sulejman pashë Bargjini», ndërtuar më 1614.

Kulla e sahatit ndërtuar më 1830 dhe xhamia e Ethem Beut që nisi të ndërtohet më 1789.

Pamje të Tiranës në fillim të shek. XX.

Pamje nga Pazari i Vjetër.



Shtëpi karakteristike tiranase në fshat dhe në qytet, varri i Kapllan Pashës dhe Ura e Tabakëve sot monumente kulture.

Ndërtesa ku u vendos më 11 shkurt 1920 qeveria e dalë nga Kongresi Kombëtar i Lushnjës, i cili e shpalli Tiranën kryeqytet të Shqipërisë.

Sheshi «Skënderbej» në Tiranën e paraçlirimit.

Rruga e Kavajës (sot «Konferenca e Pezës»).

Pamje të Pazarit të Vjetër, qendra më e rëndësishme e artizanatit dhe e tregtisë në Tiranën e paraçlirimit.

Monumenti «Partizani» kushtuar luftës për çlirimin e kryeqytetit.

Dyqani «Flora», një nga bazat e rëndësishme ku zhvilloi veprimtari komuniste shoku Enver Hoxha.

Shtëpia e thjeshtë tiranase ku u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë (sot PPSH) më 8 Nëntor 1941.

Shtëpia e Myslim Pezës, në Pezën heroike, ku më 16 shtator 1942 zhvilloi punimet Konferenca historike që hodhi themelet e pushtetit popullor.

Në këtë shtëpi të nënës kosovare Bije Vokshi, në Tiranë, më 23 nëntor 1941 u themelua Organizata e Rinisë Komuniste të Shqipërisë.

Shtëpia ku më 25 gusht 1942 u shtyp numri i parë i «Zërit të popullit», organ i Komitetit Qendror PKSH.

Bustet e Heronjve të Popullit Qemal Stafa e Vojo Kushi.

Lapidarë në Pezë, në Tiranë, në Mushqeta dhe në Priskën e Madhe, kushtuar heroizmit të partizanëve dhe popullit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Barrikadë partizane në ditët e luftës për çlirimin e Tiranës.

Tirana në ditën e çlirimit më 17 Nëntor 1944.



Miting i popullit të kryeqytetit ditën e shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë më 11 Janar 1946.

Parakalimi i brigadave partizane në rrugët e Tiranës në ditën e çlirimit të Shqipërisë më 29 Nëntor 1944.

Varrezat e Dëshmorëve të Kombit dhe monumenti «Nënë Shqipëri» ngritur në kodrat në jug të Tiranës.

Pamje e pjesshme e Tiranës.

Ndërtesa e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Ndërtesa e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH.

Pamje e pjesshme e Tiranës.

Ndërtesa e Këshillit të Ministrave të RPSSH.

Ndërtesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RPSSH.

Banka e Shtetit Shqiptar në qendër të kryeqytetit.

Një nga sheshet e Tiranës.

Pamje e Tiranës

Pamje e pjesshme në jug-perëndim të Tiranës.

Hyrja e kombinatit të tekstileve «Stalin».

Kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha».



Shtypshkronja e Re.



Kombinati i materialeve të ndërtimit «Josif Pashko».



Uzina e Antibiotikut.

Fabrika e Pasurimit të Qymyreve në Valias.

Fabrika e Parafabrikateve.



Fabrika e Tullave Silikate.

Pamje e pjesshme e Tiranës.

Kurora e gjelbërt e Tiranës

Ujëmbledhësi i Paskuqanit, një ndër veprat ujitëse më të mëdha të rrethit të Tiranës



Pamje e pjesshme e Tiranës.

Ndërtesa e Akademisë së Shkencave të RPSSH.

Qendra e Informatikës.

Korpusi kryesor i universitetit «Enver Hoxha» të Tiranës.

Shkolla
e lartë e Partisë
«V. I. Lenin».



Instituti
i Lartë Bujqësor
në Kamëz.

Institute studimore dhe projektimi.



Pamje e brendshme e Institutit të Kërkimeve Hidraulike.

Muzeu Historik Kombëtar në sheshin «Skënderbej».

Muzeu «Enver Hoxha» në bulevardin «Dëshmorët e kombit».

Pamje e Tiranës.

Ekspozita
Shqipëria sot»

Muzeu Lenin-Stalin.

Ndërtesa e redaksisë së gazetës «Zëri i popullit», organ i KQ të PPSH.

Pallati i Brigadave.

Parku i lojërave për fëmijët.

Spitali Obstetrik Gjinekologjik.

Godina e Spitalit nr. 1.



Pallati i Kulturës në kryeqytet, ku ndodhen edhe Teatri i Operës dhe i Baletit e Biblioteka Kombëtare.

Pallati i Kongreseve në bulevardin «Dëshmorët e kombit».

Ndërtesa e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Ndërtesa e Radiotelevizionit Shqiptar.

Galeria e Arteve Figurative.

Agjencia Telegrafike Shqiptare.

Kinostudioja «Shqipëria e re».

Koncert në teatrin veror të Parkut të Madh të Tiranës.

Qendra Sportive e Tiranës.

Kafe-restorant në parkun «Rinia».

Xhamia e Haxhi Ethem beut dhe kulla e sahatit të qytetit, sot monumente kulture.

Pamje e Tiranës.

Ndërtesa banimi dhe magazina tregtie në qendër të Tiranës.

Bashkimi

Pamje e pjesshme e bulevardit «Stalin».

Hotel «Tirana».

Hotel «Dajti».



Qyteti «Studenti».

Stacioni hekurudhor i Tiranës

Njësi tregtare e artikujve artizanalë.

Pikë turistike në malin e Dajtit.

Pamje e pjesshme e Tiranës.

Një ndeshje futbolli e Kampionatit Kombëtar të Kategorisë së Parë në stadiumin kombëtar «Qemal Stafa».

Pallati i sportit «Partizani».

EDUKIMIT

Qendra Sportive e Tiranës.

Valle popullore karakteristike tiranase.

Manifestim fiskulturor-sportiv i rinisë shkollore e studentore të Tiranës.

P P SH

— Komisioni redaktues:

LLAMBI GEGPRIFTI — *Kryetar*

KRISTO FRASHËRI, JASHAR MENZELXHIU, SPIRO GJIKONDI, RAMAZAN VOZGA, BESIM DAJA, NAXHI BAKALLI

— Përgatitur nga:

SKËNDER JASA, BUJAR ZAJMI

— Recensues:

Prof. SHYQYRI BALLVORA
Dr. LUAN ZELKA
PETRIT KUMI

— Fotografitë:

PETRIT KUMI, PLEURAT SUL. , NAIM KASAPI, REFIK VESELI, XHEMAL BELULI

40

Shtypur në Kombinatin Poligrafik • TIRANE - 1990

12 Lekë